



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

Në pajtim me dispozitat e nenit 12, 51, dhe 53, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 , si dhe në bazë të neneve 40 ,42 dhe 48 të Statutit të komunës së Shtërpçës nr. 01/898 të datës 14.07.2010, Kuvendi Komunal Shtërpçë në seancën e mbajtur më 29.01.2018 miratoi këtë:

VENDIM
PER FORMIMIN E KOMITETIT PER KOMUNITETE

Neni1.

Me këtë vendim formohet Komiteti per Komunitete prej anëtareve nga përbërja e Kuvendit të Komunës dhe perfaqesues te komuniteteve dhe ate ne kete perberje:

1. Gari Sahiti- Perfaqesues e komunitetit shqiptar
2. Hyrije Imeri- Perfaqesuese e komunitetit Shqiptar
3. Muhamet Emini -Perfaqesues i komunitetit Rom
4. Radojka Repinovic –Perfaqesues i komunitetit serb
5. Srdjan Kostic - Perfaqesues i komunitetit serb

Neni 2

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 3

Anëtarët e Komitetit për Komunitete nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.

Neni 4

Anëtarët e Komitetit për Komunitete të emëruar me nenin 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Ky vendim hyn ne fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Shtërpçës.

Vendimi I dergohet:

- Anetarev te zgjedhur.
- Drejtorise per buxhet dhe financa
- MAPL-se dhe
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Predrag Grbic

